

PËRFSHIRJA SOCIALE:
NJERËZIT
PAS
SHIFRAVE

Kjo broshurë e titulluar “Përfshirja Sociale: Njerëzit pas Shifrave” ofron një pasqyrë të gjendjes së përfshirjes sociale në Kosovë. Dokumenti e përshkruan gjendjen e njerëzve më të rrezikuar që jetojnë në Kosovë, duke u bazuar në të dhënat e nxjerra nga institucionet e Kosovës, agjencitë e OKB-së për zhvillim, si dhe nga forumet këshilluese dhe Akademia. Broshura paraqet pabarazitë serioze, ku shumë persona, që i përkasin grupeve specifike demografike, në mënyrë të padrejtë janë lënë prapa.



Qëllimi ynë në hartimin e këtij dokumenti është që të nxisim diskutimin aq të nevojshëm për rëndësinë e prioritizimit të investimeve në mënyrë që të zvogëlohet dallimi në mes të “të pasurve” dhe “të varfërve” në Kosovë. Bërja e përfshirjes sociale si pjesë qendrore të agjendës zhvillimore të Kosovës ka të bëjë me të drejtën e njerëzve që të jetojnë jetën pa diskriminim dhe pa pabarazi, por – ka të bëjë po aq edhe me – drejtimin e Kosovës kah realizimi i aspiratave të saj për integrim evropian dhe për respektim të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Agjencitë e OKB-së për zhvillim për një kohë të gjatë janë në partneritet me Kuvendin e Kosovës në shtyerjen përpara të dy agjendave plotësuese që përfaqësojnë dy anë të së njëjtës medalje: Agjenda e parë ka të bëjë me tetë Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZHM), që ofron një kornizë për tërë bashkësinë ndërkombëtare për të punuar së bashku drejt një qëllimi të përbashkët – për tu siguruar që zhvillimi njerëzor të arrijë tek të gjithë dhe gjithkund. Nëse arrihen këto qëllime, varfëria në botë do të përgjysmohet; dhjetëra miliona jetë do të shpëtohen dhe miliarda njerëz të tjerë do të kenë mundësi që të përfitojnë nga ekonomia globale. Agjenda e dytë ka të bëjë me Përfshirjen Sociale, ose e kundërta – me qëllimin për eliminimin e Përrjashtimit Social, ku Përrjashtimi Social mund të kuptohet si proces përmes të cilit individët ose grupet janë të përrjashtuar plotësisht apo pjesërisht nga pjesëmarrja e plotë në shoqërinë në të cilën ata jetojnë.

Rritja e prodhimit dhe shfrytëzimi i statistikave dhe hulumtimeve të sakta është qenësor për udhëheqjen e veprimit efikas për adresimin e përjashtimit social dhe për arritjen e OZHM-ve. Një sistem funksional i statistikave paraqet sytë dhe veshët e çdo kombi dhe ai është boshti kurrizor për çdo planifikim, vendimmarrje dhe për monitorimin e vendimeve dhe proceseve të politikave. Kosova duhet të jetë e kënaqur me regjistrimin e popullsisë të kohëve të fundit, si dhe me miratimin e një Ligji të fortë për Statistikat Zyrtare. Këta janë hapa të rëndësishëm drejt përgjigjeve më të mira në adresimin e përjashtimit social. Megjithatë, këta hapa duhet të pasohen me veprime të mëtejshme, duke përfshirë edhe mbështetjen në forcimin e kapaciteteve për mbledhjen dhe analizën e të dhënave si dhe për ndarjen e mjeteve adekuate financiare të nevojshme që sistemi statistikor i Kosovës të funksionojë në mënyrë efikase.

Sa na përket neve, agjencitë e OKB-së për zhvillim që punojnë nën ombrellën e Ekipit të OKB-së në Kosovë (UNKT) veprojnë sipas Planit të Përbashkët për Zhvillim (CDP) 2011-2015 i cili do të fokusohet dhe do të harmonizojë punën e agjencive të OKB-së gjatë pesë viteve të ardhshme drejt qëllimit të përgjithshëm për avancimin e Përfshirjes Sociale në Kosovë. Plani fokusohet në katër Tema Strategjike: (1) Zhvillimin e Kornizave Legjislative dhe Politike të Përfshirjes; (2) Llogaridhënien për Arritjen e Rezultateve në Përfshirjen Sociale; (3) Pjesëmarrjen dhe Fuqizimin Lokal; dhe (4) Shëndetin dhe Mbrojtjen Mjedisore. Pasi që Kosova gjithnjë e më shumë po mëton që të marrë në duar të ardhmen e vet, UNKT-ja do të vazhdojë të kultivojë partneritetin e vet me Parlamentin e Kosovës, Qeverinë, shoqërinë civile dhe sektorin privat për të avokuar dhe ofruar mbështetje dhe për përfshirje sociale

Osnat Lubrani
Koordinatorë e OKB-së për Zhvillim




Burimi: KDHS 2009 & 2003

Shtatzënitë e planifikuara



Burimi: KDHS 2009 & 2003

Shtatzënitë e planifikuara



Burimi: KDHS 2009 & 2003

Metodat efektive të kontracepsionit




Burimi: KDHS 2009

TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Në krahasimin e vitit 2009 me vitin 2003, piramidat e popullsisë tregojnë ndryshime të konsiderueshme në strukturën e moshës ndërmjet dy Studimeve Demografike dhe Shëndetësore (KDHS). Këto trende nënkuptojnë se struktura e popullsisë është duke u plakur për shkak të rënies së shkallës së pjellorisë dhe shkallës së mortalitetit që lidhet me moshën dhe emigrimin sipas moshës. Këto dinamika të popullsisë e krijojnë dividendin demografik, i cili është një dritare e mundësisë ekonomike që hapet kur në mesin e popullsisë rritet përqindja e popullsisë së moshës së punës, dhe kur ulet përqindja e personave të varur.

Popullsia është duke u plakur duke mos e zëvendësuar veten



Burimi: KDHS 2009

Planifikimi si duhet i familjes është i rëndësishëm për shëndetin e grave dhe fëmijëve duke:

- 1) parandaluar shtatzënitë që janë tepër të hershme apo tepër të vonshme;
- 2) zgjatur periudhën ndërmjet lindjeve; dhe
- 3) planifikuar numrin e lindjeve të dëshiruara

Një planifikim më i mirë i familjes ndihmon në kufizimin e numrit të abortimeve që një femër përndryshe do të ketë për shkak të shtatzënitë të padëshiruara ose paplanifikuara.

Shkalla e ulët (dhe që vazhdon të ulët) e përdorimit të metodave efektive të kontracesionit (9.2%) dhe mbështetja e çdo të katërtës femër (25.2%) në metodën relativisht joefektive të tërheqjes janë arsye për shqetësim. Familjet kosovare po bëhen më të vogla, megjithatë mënyrat e përdorimit të kontraceutivëve dhe zgjedhja e metodave nuk është në përputhje me dëshirën për familje më të vogla dhe femrat po rrezikohen nga shtatzënitë e padëshiruara, e që më vonë mund të vendosin të abortojnë. Shkalla e përgjithshme e pjellorisë (TFR) është 2.03 fëmijë për një grua, që është pak nën nivelin e pjellorisë zëvendësuese prej 2.1 fëmijësh, ku 0.1 llogaritet për fëmijët që nuk mbijetojnë për të riprodhuar dhe që paraqet TFR-në me të cilën secili çift e zëvendëson veten. TFR-ja e llogaritur në DHS 2003 ka qenë 2.98 – pothuaj për një fëmijë më e lartë se TFR-ja e llogaritur në studimin e vitit 2009. Shkalla e pjellorisë në vitin 2003 ka qenë më e larta në rajon në të cilin plakja e popullsisë është gjë e zakonshme dhe shumica e vendeve evropiane e kanë kaluar këtë tranzicion demografik dhe tani kanë shkallë më të vogël të pjellorisë.

Shkalla e tanishme e pjellorisë është nën nivelet e zëvendësimit dhe është në rënie



Burimi: KDHS 2009 & 2003

Familjet kosovare vazhdojnë të jenë tradicionalisht të mëdha ku një familje shpesh përfshinë anëtarë të familjes së gjerë që përfshijnë disa gjenerata, veçanërisht në zonat rurale.

83% e familjeve kanë 4 ose më shumë anëtarë



30% e familjeve kanë 7 e më shumë anëtarë



Nën kufirin e varfërisë

(nuk ka mjaft për të blerë më shumë se ushqim)



Burimi: Banka Botërore 2010

Nën kufirin e varfërisë ekstreme

(nuk ka mjaft për të blerë ushqimin e nevojshëm për mbijetesë)



Burimi: Banka Botërore 2010

Shkalla e përjashtimit të familjet rome, ashkali dhe egjiptiane



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

36% e familjeve nuk kanë qasje në të gjitha shërbimet komunale




Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

ZVILLIMI NJERËZOR

Indeksi i Zhvillimit Njerëzor i Kosovës (HDI), një matje kritike e progresit të vendit për njerëzit, që mat qasjen në arsim, shëndetësi dhe ekonomi, është më i ulët në Evropë.

HDI-ja më e ulët në Evropë




Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

VARFËRIA

Varfëria është më e lartë tek ata që jetojnë në familje të mëdha, që jetojnë me shumë pjesëtarë të papunë dhe te ata që kanë nivel të ulët të arsimimit. Është me rëndësi të theksohet se vetëm punësimi nuk e mbron një familje nga varfëria pasi që 6.4% e familjeve të varfra kanë pasur anëtarë të punësuar në familjen e tyre. Për më tepër, një numër relativisht i lartë i familjeve (7.6%) nuk kanë biznese e as tokë të punëshme dhe janë të papunë.

Nga grupet e popullsisë etnike në Kosovë, komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane kanë shkallën më të lartë të përjashtimit me më shumë se 40% të përjashtuar nga të gjithë faktorët e tregut, që nënkupton se ata nuk e kanë askënd nga familja të punësuar, nuk kanë biznes, objekt për ta lëshuar me qira, tokë për të punuar ose pasuri për ta shitur në treg.


Komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane janë grupi më i përjashtuar nga të gjithë faktorët e tregut



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

Rreth 48% e fuqisë punëtore ka qenë e papunë në vitin 2008, përderisa shkalla e papunësisë tek të rinjtë ka qenë 70%. Papunësia ka prirje që të jetë afatgjate, ku afërsisht 82% e të papunëve mbesin jashtë pune për më shumë se 12 muaj. Tregu i punës rritet për mesatarisht 30,000 punëkërkues të rinj çdo vit, që kanë shumë pak mundësi në dispozicion.

Papunësia e të rinjve është shumë më e lartë se sa papunësia e përgjithshme që po ashtu është e lartë



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010


Duke pasur parasysh kontekstin, nuk është befasi që papunësia te femrat është pothuaj 50% më e lartë se papunësia te meshkujt.

Çdo i treti kosovar rrezikohet që të mos ketë sa duhet për të blerë diçka më shumë se ushqimi

Çdo i gjashti kosovar rrezikohet nga uria duke mos pasur sa duhet për të blerë ushqim për plotësimin e nevojave ditore për kalori

Vetëm një në çdo gjashtë kosovarë mund të kenë qasje te mjeku dhe ilaçet pa pasur problem financiar apo barriera social.

Papunësia



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

Duke pasur parasysh kontekstin, nuk është befasi që papunësia te femrat është pothuaj 50% më e lartë se papunësia te meshkujt. Ngjashëm shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është dukshëm më e ulët për femrat me 26.1% krahasuar me 65.8% sa është për meshkujt, e cila në fakt është më afër mesatares së pjesëmarrjes së femrave në Bashkimin Evropian me 64%.

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

Femrat e punësuar në administratën publike



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

Gjinia e ministrave dhe zëvendës ministrave




Ministrat



Zëvendësit


Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

Papunësia te femrat është dukshëm më e lartë se sa papunësia te meshkujt



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

Pjesëmarrja e femrave kosovare në fuqinë punëtore është më e ulët se në vendet e tjera evropiane



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

PJESËMARRJA NË POLITIKË

Ka pasur përpjekje të admirueshme për të rritur pjesëmarrjen e femrave në sferën politike. Derisa 1.3 e Këshilltarëve të Presidentes janë femra vetëm $\frac{1}{4}$ e tyre janë në nivelin politik. Po ashtu 1 në 3 anëtarë të Kuvendit janë femra por vetëm 2 nga 16 komisionet udhëhiqen nga femrat.



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

Fatkeqësisht të njëjtat përparime nuk kanë ndodhur edhe në sferën e administratës publike ku femrat i mbajnë $\frac{1}{5}$ e vendeve të punës, me vetëm një rritje të papërfillshme që nga viti 1999. Madje, në komunitetet pakicë asnjë prej pozitave të larta nuk i mbajnë femrat. Për më tepër, përafërsisht 1 në 4 pozitat në nivelin komunal e mbajnë femrat por asnjë pozitë të kryetarit të komunës.

Kryetarët e Komunave



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

Në nivelin e qeverisë ka mospërputhje të mëdha sa i përket barazisë gjinore ku vetëm 2 nga 19 ministrat e qeverisë janë femra dhe vetëm 1 nga 30 zëvendës ministrat është femër.

Një prej pengesave për integrimin gjinor është fakti se Zyrtarët për Barazi Gjinore nuk janë emëruar në të gjitha ministritë dhe se komisionet për barazinë gjinore janë krijuar në vetëm dy nga 30 komuna.

Papunësia tek femrat është pothuaj 50% më e lartë se tek meshkujt

Ngjashëm, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është dukshëm më e ulët për femrat me 26.1% krahasuar më mesataren e Bashkimit Evropian prej 64%.

Vetëm 2 nga 16 komisionet udhëhiqen nga femrat

Vetëm 1 nga 30 zëvendësministrat është femër

Vijueshmëria e moshës 5-9



Burimi: KDHS 2009 & 2003

Vijimi i shkollës fillore nga romët, ashkallitë dhe egjiptianët




Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

Vijimi i shkollës së mesme nga romët, ashkallitë dhe egjiptianët



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

Barazia gjinore e fëmijëve me aftësi të kufizuara



Burimi: Të dhënat e MASHT

Shkollimi në fëmijërinë e hershme (mosha 5-6)




Burimi: të dhënat e MASHT-it 2008/2009

ARSIMI

Kosova ka përparuar në sektorin e arsimit viteve të fundit dhe ka një shkallë të lartë të vijueshmërisë të grupmoshat 10-14 vjeçare (98%). Megjithatë ekziston një shqetësim se shkalla e vijueshmërisë të grupmoshat 5-9 vjeçare me 79.6% është e ulët edhe pse ka pasur një rritje të vijueshmërisë nga 66% sa ka qenë më 2003. Shkalla e vijueshmërisë së mësimin të nxënësit të moshës 15-19 vjeçare po ashtu është rritur ndërmjet viteve 2003 dhe 2009 nga 63% në 77% por kjo është një fushë që kërkon vëmendje për të zhdukur dallimet.

Vetëm 4 nga çdo 5 fëmijë ndërmjet moshës 5-9 dhe 15-19 vjeçare e vijnë në mësimin




Burimi: KDHS 2009

Arsimi është parakusht jetik për luftimin e varfërisë, fuqizimin e femrave, mbrojtjen e fëmijëve nga puna e rrezikshme dhe shfrytëzuese dhe nga shfrytëzimi seksual, për promovimin e të drejtave të njeriut dhe demokracisë, mbrojtjen e mjedisit dhe ndikimin në rritjen e popullsisë.

Të dhënat nga Ministria e Arsimit (MASHT) për vitin akademik 2008/2009 tregojnë se vetëm 70% e fëmijëve të moshës 5-6 vjeçare shkojnë në shkollë. Fatkeqësisht, edhe pse janë bërë përpjekje të mëdha në fushën e arsimit ka pasur shumë pak ndryshime në indeksin e paritetit gjinor (GPI) ose në përqindjen e femrave në raport me meshkujt në nivelet e ndryshme të sistemit arsimor.

Është shqetësues fakti se GPI nuk ka ndryshuar në aspektin statistikor në 6 vitet e fundit që nënkupton se vajzat ende janë të përjashtuara nga qasja në shkollim, veçanërisht në nivelin e mesëm të lartë ku shkalla e përgjithshme shoqërore e djemve në raport me femrat është ekuivalente dhe kësaj fushe duhet kushtuar vëmendjen e duhur.

Nuk ka ndryshim statistikor në përqindjen e vajzave në raport me meshkujt që vijojnë shkollën



Burimi: 2010 Faktet për OZHM

Gjatë dy viteve të fundit, vajzat kanë pasur një shkallë më të ulët se mesatarja e tranzicionit nga niveli i mesëm i ulët në nivelin e mesëm të lartë krahasuar me djemtë.

Shkalla e tranzicionit nga arsimiti i mesëm i ulët në atë të lartë



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

Shkalla e vijueshmërisë së grupmoshës 5-9 vjeçare është e ulët (79.6%) edhe pse është rritur nga 66% sa ka qenë në vitin 2003

Vetëm 7 nga 10 fëmijët e moshës 5-6 shkojnë në shkollë edhe pse kjo është fazë e formimit dhe zhvillimit të tyre edukativ

Gjatë 6 viteve të fundit nuk ka pasur ndryshime statistikore sa i përket përqindjes së vajzave që vijojnë mësimin në raport me djemtë

Kostoja si pengesë kryesore për përkujdesjen shëndetësore



Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010

Vdekjet nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut



Burimi: Shkaqet e Vdekjes 2009

Vdekjet e pakodifikuara



Burimi: Shkaqet e Vdekjes 2009

Pengesat kryesore për qasje në përkujdesje shëndetësore




Burimi: Shkaqet e Vdekjes 2009

Komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane janë më të marginalizuarat sa i përket qasjes në arsim ku vetëm 1 nga 70 pjesëtarë të këtyre komuniteteve e ka vijuar ose përfunduar shkollën e mesme e edhe më pak prej tyre e kanë përfunduar ose vijuar universitetin.

Shkrim-leximi dhe arsimimi i plotë janë ngushtë të lidhura me shanset jetësore siç janë portretizuar në Studimin e fundit të Mozaikut të UNDP-së i cili ka demonstruar se nivelet e shkollimit lidhen në mënyrë pozitive me nivelet e punësimit, d.m.th, ata që kanë përfunduar më shumë vite shkollimi kanë më shumë gjasa që të punësohen.

14% e personave pa arsim formal janë të punësuar krahasuar me 67% të atyre me arsimim të lartë




Burimi: Studimi i Mozaikut të Kosovës 2009

SHËNDETI

Gjendja shëndetësore është përmirësuar gjatë dekadës së fundit por prapëseprapë kosovarët jetojnë prej 2 deri në 6 vjet më pak se qytetarët e vendeve fqinje. Përderisa qytetarët më të pasur kërkojnë trajtim jashtë vendit, shumë pengesa ua vështirësojnë kosovarëve qasjen në shërbime shëndetësore. Investimet relativisht të ulëta në shëndetësi, kostoja e shërbimeve dhe qasja e vështirë në shërbimet adekuate janë vetëm disa shembuj të pengesave ekzistuese institucionale, socio-kulturore dhe mjedisore.

Në këtë kontekst, përfshirja sociale mbetet një sfidë në fushën e shëndetësisë. Të rinjtë, njerëzit që jetojnë me aftësi të kufizuara dhe komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane mund të konsiderohen si popullsi më e rrezikuar që preket nga përjashtimi nga përkujdesja shëndetësore, pasi që qasja e tyre në përkujdesje shëndetësore shpesh është veçanërisht e vështirë.

Përkundër përpjekjeve të konsiderueshme në kodifikimin e vdekjeve, për 19.4% të vdekjeve në vitin 2009 nuk është dhënë kurrfarë diagnoze duke ilustruar imperativin për mbledhjen e të dhënave në sektorin e shëndetësisë për të identifikuar nevojat e kosovarëve dhe për të qenë në gjendje për t'i adresuar ato.



Burimi: KDHS 2009

Ndarja e buxhetit të Kosovës për shëndetësi mbetet relativisht e ulët që sillet nga 35 deri në 45 Euro për kokë banori, e cila është tri deri në pesë herë më e ulët se në vendet fqinje.

FACTORS	%
<ul style="list-style-type: none"> • Distance to doctor's office/hospital/medical centre • Delay in getting appointment • Waiting time to see doctor on day of appointment • Cost of seeing the doctor • Cost of buying medicines 	
None of the above factors	15.2
1-4 of the above factors	57.8
All the above factors	27.0

Ndonëse shumë kosovarë kanë dëgjuar për HIV/AIDS, shumica e tyre nuk janë të informuar në mënyrë adekuate

Pirja e duhanit gjatë dhe pas shtatzënisë është dukuri e zakonshme dhe paraqet rrezik për shëndetin e tërë familjes

Gjysma e fëmijëve rriten në ambient familjar ku pihet duhani

Njohuritë për ekzistimin e HIV/AIDS



Burimi: KDHS 2009

HIV/AIDS

Kosova ka një shkallë të vogël të përhapjes së HIV/AIDS (<1% e popullsisë) dhe më pak se 5% tek grupet më të rrezikuara. Megjithatë, gjendja mbetet e paqartë për shkak të mos-raportimeve dhe për shkak të mungesës së parandalimit tek grupet më të rrezikuara, sjelljet e tyre ndaj rrezikut duket se janë duke u bërë më të zakonshme. Numri në rritje i përdoruesve intravenoz të drogës, punëtoreve të seksit, komunitetet e diskriminuara MSM, ndryshimi i normave shoqërore, komuniteti i madh mobil dhe migrues dhe vetëdija e ulët për metodat e parandalimit të HIV-it paraqesin faktorë të rrezikut, të cilat sektori i dobët i shëndetësisë e ka të vështirë t'i adresojë.

Do të blinin perime nga një shitës që jeton me HIV/AIDS



Burimi: KDHS 2009

Njohuria për ekzistimin e HIV/AIDS-it është e lartë, ku afërsisht 90% e meshkujve dhe 80% e femrave mbi moshën 15 vjeçare kanë dëgjuar për të. Fatkeqësisht, ekziston një stigmatizim i njerëzve që jetojnë me HIV/AIDS që ilustron me shkallën e ulët prej 40.5% të meshkujve dhe 33.3 të femrave që do të blinin perime nga ndonjë shitës që jeton me HIV/AIDS. Nevoja për sensibilizimin rreth kësaj teme është veçanërisht e lartë në zonat rurale.

TË USHQYERIT

Pirja e duhanit gjatë shtatzënisë



Burimi: KDHS 2009

Femrat shtatzëna dhe foshnjat e tyre janë më të shëndetshme për shkak të të ushqyerit adekuat, përderisa shumë sjellje të rrezikshme mbesin akoma të përhapura. Në mesin e femrave shtatzëna, 23% e tyre kanë probleme me aneminë, që kryesisht shkaktohet nga mungesa e hekurit. Me një furnizim më të mirë të kripës së jodizuar, Kosova duket se e ka trajtuar problemin pasi që popullsia e saj ka arritur një status adekuat të të ushqyerit me jod.

Duhani

Fëmijët që rriten në ambient ku pihet duhani



Burimi: KDHS 2009

Pirja e duhanit paraqet rrezikun më të madh për shëndetin publik të fëmijëve në Kosovë, dhe një studim i kohëve të fundit ka konstatuar se 20.9 për qind e femrave shtatzëna pinë duhan gjatë shtatzënisë (OBSh, 2010), dhe mbi 60 për qind e të porsalindurve i ekspozohen tymit të cigares çdo ditë; në faktorët e tjerë të rrezikut për mjedisin hyjnë nivelet e rrezikshme të larta të ndotjes me plumb dhe metale të tjera të rënda (zona e Mitrovicës).

PËR NE

Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT) është një grup prej 21 agjencish dhe subjektsh të OKB-së që janë të pranishme në Kosovë, ku hyjnë OHCHR, UNICEF, UNFPA, UNHCR, IOM, OBSH, FAO, ILO, UNDP, UN-HABITAT, UNOPS, UNWOMEN, UNV si dhe Agjencitë e tjera jo-rezidente, UNESCO, UNEP, UNCTAD, UNODC, dhe UNIDO. Edhe FMN-ja dhe Banka Botërore janë po ashtu anëtare të UNKT-së. Të gjithë anëtarët e UNKT-së e kanë një zotim të përbashkët afatgjatë për mirëqenien e të gjithë njerëzve në Kosovë, secili në fushën e vet përkatëse të specializimit – qoftë në shëndetësi, arsim, të drejta të njeriut dhe të fëmijëve, fuqizim të grave (femrave) dhe barazi gjinore, qeverisje të mirë, bujqësi, ndihmë për emigrantët që kanë nevojë, refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit, ndihmë në vendbanimet urbane dhe rurale, zhvillim ekonomik dhe punësim.

Ato janë mbledhur nën ombrellën e UNKT-së për të harmonizuar intervenimet, për të adresuar të gjitha aspektet e sfidave zhvillimore të Kosovës dhe për të punuar me qeverinë, shoqërinë civile dhe sektorin privat që së bashku të synojnë arritjen e Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit, e cila është kornizë e të gjitha agjencive ndërkombëtare, me një qëllim të përbashkët – të sigurojnë që të gjithë të kenë mundësi të barabartë që të përfshihen në mënyrë aktive në shoqërinë kosovare.

UNKT kryesohet nga Koordinatorja e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDC), e cila e mbështet dhe lehtëson dialogun dhe bashkërendimin e UNKT-së për të siguruar bashkëpunimin në mënyrë të bashkërenduar dhe harmonizuar, me qëllim që të përmirësohet efikasiteti dhe efektiviteti i përgjithshëm i intervenimeve të UNKT-së në Kosovë.

Kontakti: +381 38 249 066 Lok. 157, www.unkt.org